



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

DATE/DANA:	03.02.2023
REFERENCE/PREPORUKA	12 Nr. 13/2022
PËR/ZA/TO:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Elianë Blakaj, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim

Njoftim

Duke u bazuar në **Rregulloren Komunale Nr.1/2021- Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së Paluajtshme të Komunës**, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport njofton të gjithë personat fizik dhe juridik, Organizatat Joqeveritare, Klubet si dhe Bizneset Profitabile për të aplikuar me anë të kërkesës zyrtare me shkrim për dhënie në shfrytëzim për hapësirat e objekteve kulturore, rinore të cilat i takojnë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sport:

1. Shfrytëzimi i hapësirës në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari"
2. Zyret në Shtëpi të Kulturës "Adem Jashari"- Istog

Aplikimi bëhet në objektin e Komunës në QSHQ zyrën nr.100, aplikimi fillon nga data 06.02.2023 deri me datën: 24.02.2023 ora:16:00.

Bashkangjitur në link gjeni dokumentacionin e nevojshëm për kompletim të kërkesës.

Tel | Cell: +383 49 634 500

Email: eliane.blakaj@rks-gov.net

Web: <https://kk.rks-gov.net/Istog/>

Adresa | Address: Rr/Str "Fadil Ferati", nr. 121, kati/ floor 0 | zyra/ office 115 | 31 000 - Istog/ Istok

Kushtet për aplikim:

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marr në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:

2. Formularin e plotësuar të cilin e gjenë në QSHQ;

1.2. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik ;

1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik ;

1.4. Historiati i biznesit që aplikon ;

1.5. Veprimtaria që do të zhvillojë;

1.6. Projekti ideor ;

1.7. Vërtetimi nga Komuna për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;

2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse

Për shoqëri civile:

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së Komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë Rregullore.

2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) dië deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të Komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitektura historike, panairt e të ngjashme.

3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim

vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga Drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e Komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga Drejtori i Drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

Vëmendje:

Kompenzimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit përcaktohet me **Rregullore të Komunës për taksa komunale**

E drejta e Ankesës:

Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të Komunës në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.